

LegalNews

February 2022
Shkurt 2022



Ligji nr. 6/2022 'Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 112/2020 "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues" të ndryshuar'

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka miratuar, më datë 27.01.2022, Ligjin nr. 6/2022 'Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 112/2020 "Për regjistrin e pronarëve përfitues" të ndryshuar' (në vijim "Ligji"), i cili ndryshon ligjin ekzistues nr. 112/2020.

Ky Ligj synon rritjen e numrit të raportimeve të pronarëve përfitues, duke përbushur në të njëjtën kohë rekomandimet e ekspertëve të MONEYVAL, të cilët kërkojnë që Shqipëria të krijojë mekanizma për nxitjen e subjekteve raportuese drejt regjistrimit të të dhënave të pronarëve të tyre përfitues.

Më konkretisht, disa nga ndryshimet kryesore të Ligjit janë si në vijim:

- Shtyrja e afatit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese ekzistuese, deri më **30.06.2022**.
- Falja e gjobave të vendosura për mospërbushje në kohë të detyrimeve ligjore ndaj subjekteve raportuese ekzistuese lidhur me regjistrimin e pronarëve përfitues, me kusht që këto detyrime të përmbushen jo më vonë se data **30.06.2022**.
- Subjektet raportuese, të cilat përpara datës së hyrjes në fuqi të Ligjit kanë paguar gjobat që falen sipas parashikimeve të mësipërme dhe kanë përmbushur

Law no. 6/2022 'On some amendments and additions to Law no. 112/2020 "On the Register of Ultimate Beneficiary Owners" as amended'

The Parliament of the Republic of Albania has approved, on 27.01.2022, Law no. 6/2022 'On some amendments and additions to Law no. 112/2020 "On the register of ultimate beneficiary owners" as amended' (hereinafter "the Law"), which amends the existing law no. 112/2020.

This Law aims to increase the number of reports of ultimate beneficial owners, while simultaneously fulfilling the recommendations of MONEYVAL experts, who request that Albania establishes mechanisms to encourage reporting entities to register data of their ultimate beneficial owners.

More specifically, some of the main amendments to the Law are as follows:

- The extension of the deadline for initial reporting of beneficial owners by existing reporting entities, until **30.06.2022**.
- The remission of fines imposed for timely non-fulfillment of legal obligations to existing reporting entities regarding the registration of beneficial owners, provided that these obligations are met no later than **30.06.2022**.
- Reporting entities, which before the date of entry into force of the Law have paid the fines remitted according to the above provisions and have fulfilled the relevant

detyrimet përkatëse për regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues, kanë të drejtë të aplikojnë pranë Qendrës Kombetare të Biznesit ("QKB") për rimbursimin e shumave të paguara.

- Aplikimi për regjistrimin e pronarëve përfitues nga subjektet raportuese të reja që regjistrohen në Regjistrin Tregtar, do të bëhet njëkohësisht me aplikimin për regjistrimin e personit juridik. Të dyja aplikimet do të realizohen në sportelet e QKB. Në rast se ky aplikim i njëkohëshëm për regjistrimin e pronarëve përfitues refuzohet për shkak të mangësive, subjektet raportuese duhet të riparaqesin aplikimin tashmë brenda 40 ditëve kalendarike.
- Dhënien e mundësisë së pezullimit të aplikimit për regjistrimin fillestar, ndryshimin apo përditësimin e të dhënave, duke i dhënë subjektit raportues një afat prej 30 ditësh kalendarike për plotësimin e të metave që pengojnë regjistrimin, duke hequr kështu mundësinë e refuzimit të menjëhershëm.
- Shtyrja e afatit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese të reja që regjistrohen në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, tashme brenda një afati 40 ditor.
- Ndryshime në masën e kundravajtjes administrative mbi bazën e vonesës së raportimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen në

obligations for the registration of their beneficial owners, have the right to apply to the National Business Center ("NBC") for reimbursement of amounts paid.

- The application for registration of ultimate beneficial owners by reporting entities that are newly registered in the Commercial Register, will be done simultaneously with the application for registration of a legal entity. Both applications will be made at the NBC counters. In case such simultaneous application for registration of ultimate beneficial owners is rejected due to deficiencies, reporting entities must resubmit the application within 40 calendar days.
- Providing the possibility of suspending the application for initial registration, changing or updating the data, giving the reporting entity a period of 30 calendar days to complete the deficiencies that prevent registration, thus eliminating the possibility of immediate rejection.
- Postponement of the deadline for the initial reporting of ultimate beneficial owners by reporting entities newly registered in the Register of Non-Profit Organizations to within a period of 40 days.
- Changes in the administrative penalty measure on the basis of delay in the initial reporting of beneficial owners by reporting entities registered in the respective register and on

regjistrin përkatës dhe mbi bazën e mosregjistrimit të ndryshimeve në të dhënat e regjistruara si vijon:

- Në rastet e refuzimit të aplikimit për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, që regjistrohen në regjistrin tregtar me pronësi indirekte, regjistrimi bëhet brenda 40 (*dzyzet*) ditëve kalendarike nga data e refuzimit të aplikimit. Mosregjistrimi fillestar i të dhënave për pronarin përfitues të tij brenda këtij afati dënohet me gjobë në vlerën 50 000 (*pesëdhjetë mijë*) lekë;
- Në rastet e regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, që regjistrohen në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, regjistrimi bëhet brenda 40 (*dzyzet*) ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese si person juridik. Mosregjistrimi fillestar i të dhënave për pronarin përfitues të tij brenda këtij afati dënohet me gjobë në vlerën 50 000 (*pesëdhjetë mijë*) lekë;
- Në rastet e refuzimit të aplikimit për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, që regjistrohen në regjistrin tregtar me pronësi indirekte, regjistrimi bëhet brenda 40 (*dzyzet*) ditëve kalendarike nga data e refuzimit të aplikimit. Mosregjistrimi fillestar i të dhënave për pronarin përfitues të tij brenda 40 (*dzyzet*) ditësh pas përfundimit të afatit të

the basis of non-registration of changes in the registered data as follows:

- In cases of rejection of the application for initial registration of beneficial owners by reporting entities, which are registered in the commercial register, with indirect ownership, the registration is done within 40 (*forty*) calendar days from the date of rejection of the application. Initial non-registration of data for beneficial owner within this period is punished with a fine in the amount of 50,000 (*fifty thousand*) ALL.
- In cases of initial registration of beneficial owners by reporting entities, which are registered in the Register of Non-Profit Organizations, registration is done within 40 (*forty*) calendar days from the date of registration of reporting entities as a legal entity. Initial non-registration of data on its beneficial owner within this deadline is punished with a fine in the amount of 50,000 (*fifty thousand*) ALL.
- In cases of rejection of the application for initial registration of beneficial owners by reporting entities, which are registered in the commercial register, with indirect ownership, the registration is done within 40 (*forty*) calendar days from the date of rejection of the application. Initial non-registration of data for beneficial owner within 40 (*forty*) days after the

përcaktuar dënohet me gjobë në vlerën 600 000 (*gjashtëqind mijë*) lekë;

- Në rastet e regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, që regjistrohen në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, regjistrimi bëhet brenda 40 (*dyzet*) ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese si person juridik. Mosregjistrimi fillestar i të dhënave për pronarin përfitues të tij brenda 40 (*dyzet*) ditësh pas përfundimit të afatit të përcaktuar dënohet me gjobë në vlerën 600 000 (*gjashtëqind mijë*) lekë;

- Në rastin e regjistrimit të ndryshimeve të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, regjistrimi bëhet brenda 90 (*nëntëdhjetë*) ditëve kalendarike nga data e ndodhjes së ndryshimit faktik. Mosregjistrimi i çdo ndryshimi në të dhënat e regjistruara, që depozitohen në regjistër, brenda afatit të përcaktuar dënohet me gjobë në vlerën 400 000 (*katërqind mijë*) lekë;

- Subjektet raportuese kanë detyrimin të ruajnë dhe të mbajnë të dhëna dhe dokumente shoqëruese të duhura, të sakta e të përditësuara, në bazë të të cilave përcaktohen pronarët përfitues të subjektit dhe lloji i kontrollit të pronarëve të tyre përfitues, mospërbushja e këtyre detyrimeve ligjore përbën

expiration of the specified term is punished with a fine in the amount of 600 000 (*six hundred thousand*) ALL.

- In cases of initial registration of beneficial owners by reporting entities, which are registered in the Register of Non-Profit Organizations, registration is done within 40 (*forty*) calendar days from the date of registration of reporting entities as a legal entity, initial non-registration of data on its beneficial owner within 40 (*forty*) days after the expiration of the specified term is punished with a fine in the amount of 600,000 (*six hundred thousand*) ALL.

- In case of registration of changes in the data of the beneficial owners of the reporting entities, the registration is done within 90 (*ninety*) calendar days from the date of occurrence of the actual change. Failure to register any change in the registered data, which are deposited in the register, within the specified period is punishable by a fine in the amount of 400,000 (*four hundred thousand*) ALL.

- Reporting entities have the obligation to maintain appropriate, accurate and up-to-date data and accompanying documents, based on which the beneficiary owners of the entity are determined and the type of control of their beneficiary owners. Non-fulfillment of these legal obligations constitutes an

kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në vlerën 50 000 (*pesëdhjetë mijë*) lekë.

- QKB-ja dhe autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse për subjektet raportuese, nuk do të ofrojnë shërbimet ndaj subjekteve të cilat kryejnë shkeljet e parashikuara më lart, përveç regjistrimit të ndryshimeve të të dhënave të përfaqësuesit ligjor, si dhe do të ndryshojnë statusin për subjektet raportuese nga statusi "aktiv" në statusin "të pezulluar" në regjistrin tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse deri në pagimin e gjobës dhe regjistrimin e të dhënave përkatëse për pronarët përfitues.

Ligji është publikuar ne Fletoren Zyrtare nr. 25, date 15.02.2022 dhe do të hyjë në fuqi 15 dite pas publikimit te saj.

administrative violation and is punished with a fine in the amount of 50,000 (*fifty thousand*) ALL.

- The NBC and the authority responsible for maintaining the Register of Non-Profit Organizations for reporting entities, will not provide services to reporting entities which commit the violations provided above, except for the registration of changes in the data of the legal representative, and will also change the status of reporting entities from "active" status to "suspended" status in the commercial register and the Register of Non-Profit Organizations until the payment of the fine and the registration of relevant data for the beneficial owners.

The Law has been published with the Official Gazette no. 25, dated 15.02.2022 and will enter into force 15 days after its publication.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Sabina Lalaj

Local Legal Partner
Deloitte Legal sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mobile: + 355 68 37 33 130
E-mail: slalaj@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.